


**PESHQIT
E
LUMIT BUNA
DHE
DELTËS
SË SAJ**



**PESHQIT E
LUMIT BUNA
DHE DELTËS SË SAJ**



ISBN: 978-9928-820-76-1

© 2025 PPNEA

Titulli: PESHQIT E BUNËS DHE DELTËS SË SAJ

Përgatiti: Redon Hasanllari, Xhemal Xherri

Redaktimi teknik: Ledi Selgjekaj

Redaktim: Lorena Pyze Xhafaj, Tea Gjonaj

Ilustrimet: OpenAI, DALL·E

Shtypur: M&B Botime dhe Studio Grafike

Mirënjohje

Ky libërth është realizuar në kuadër të projektit “Vendosja e bazave për një të ardhme të qëndrueshme për Peizazhin e Mbrojtur Lumi i Bunë-Velipojë në Shqipëri dhe Deltën e Bojanës në Malin e Zi”, mbështetur nga Critical Ecosystem Partnership Fund (CEPF) dhe zbatuar nga PPNEA, në bashkëpunim me Environment Programme në Malin e Zi.

Fondi i Partneritetit për Ekosistemet Kritike (CEPF) është një nismë e përbashkët e Agjencisë Franceze për Zhvillim (l'Agence Française de Développement), Conservation International, Bashkimit Evropian, Fondacionit Hans Wilsdorf, Mekanizmit Global të Mjedisit (Global Environment Facility), Qeverisë së Japonisë dhe Bankës Botërore. Në rajonin e Mesdheut, financime shtesë janë siguruar nga Fondacioni MAVA, Fondacioni Audemars-Watkins dhe Nisma e Donatorëve për Ekosistemet e Ujërave të Ëmbla Mesdhetare (DIMFE).

Për përgatitjen e këtij materiali duam të shprehim mirënjohjen tonë ndaj Prof. Spase Shumka për ndihmën teknike dhe këshillat e dhëna, që botimi të jetë sa më i plotë. Libërtha të tillë që synojnë të tejkëqojnë informacione të vlefshme kanë gjithmonë nevojë për përmirësim, ndaj ne presim sygjerrime apo komente, të cilat mund t'i dërgoni në e-mailin: contact@ppnea.org.

Tabela e përmbajtjes:

Parathënie	5
Lumi Buna/Bojana	5
Peizazhi i Mbrojtur Lumi i Bunës-Velipojë	7
Shumëllojshmëria biologjike	10
Peshqit	11
Problematikat kryesore që rrezikojnë peshqit	12
Peshkimi i paligjshëm	13
Braktisja ose hedhja e materialeve të peshkimit në ujë	13
Shkarkimi i ujërave të zeza dhe ato bujqësore	14
Marrja e interteve	14
Simbole / Legjenda	15
Familja <i>Acipenseridae</i>	16
Familja <i>Anguillidae</i>	18
Familja <i>Atherinidae</i>	19
Familja <i>Nemacheilidae</i>	20
Familja <i>Blennidae</i>	21
Familja <i>Petromyzontidae</i>	22
Familja <i>Centrarchidae</i>	23
Familja <i>Cobitidae</i>	24
Familja <i>Citharidae</i>	26
Familja <i>Cyprinidae</i>	27
Familja <i>Gasterosteidae</i>	39
Familja <i>Gobidae</i>	40
Familja <i>Ictaluridae</i>	42
Familja <i>Moronidae</i>	43
Familja <i>Mugilidae</i>	44
Familja <i>Percidae</i>	46
Familja <i>Poeciliidae</i>	47
Familja <i>Salmonidae</i>	48
Literatura	51
Lista e llojeve	52


Parathënie

Lumi Buna/Bojana

Lumi Buna është një lumë fushor që buron nga pika më jugore e liqenit të Shkodrës. Së bashku me deltën e tij, përbëjnë një zonë me rëndësi të madhe ndërkombëtare. Kjo zonë ndërkufitare, e ndarë mes Shqipërisë dhe Malit të Zi, gëzon status mbrojtje dhe është pjesë e disa rrjeteve kyçe ekologjike, si KBA, IPA, IBA, Ramsar, dhe është zyrtarisht njohur si zonë Kandidat Emerald. Si i vetmi emisar i liqenit të Shkodrës, lumi rrjedh për 44 kilometra, duke e lidhur liqenin me detin Adriatik. Me një gjerësi prej 0.35–0.5 km dhe thellësi 2–4 metra, rrjedha e sipërme e lumit kalon në drejtimin jugperëndimor, duke vazhduar drejt jugut përmes fushave bregdetare deri sa derdhet në Adriatik.

Buna bashkohet me lumin Drin, pellgun më të madh ujëmbledhës në Shqipëri, duke formuar së bashku peizazhe të jashtëzakonshme dhe kënetat e deltës, të cilat janë habitate të rëndësishme për qindra lloje. Pavarësisht transformimeve dhe presioneve antropogjene, lumi vazhdon të mbetet një zonë me vlera të larta biodiversiteti.

Në vitin 2024, me një mision të veçantë për të gjetur “mistikun”, blinin e bardhë (*Acipenser naccarii*), dhe për të identifikuar shumëllojshmërinë e peshqve në këtë lum, PPNEA kreu një studim përmes metodës me ADN përgjatë gjithë gjatësisë së lumit dhe deltës së tij. Nga ky studim u identifikuan gjithsej 31



lloje peshqish, por fatkeqësisht Blini i bardhë nuk ishte ndërta. Kjo është një thirrje për të gjithë aktorët e interesuar që të ndërgjegjësohen për situatën aktuale dhe të ndërmarrin hapa për ndërhyrje, zbutje dhe restaurim.

Peshkimi është një nga aktivitetet më të hershme dhe më të rëndësishme për njerëzimin, duke siguruar ushqim, punësim dhe mirëqenie ekonomike e sociale. Ai është po aq i rëndësishëm dhe i domosdoshëm sa është edhe i cenueshëm sot dhe për brezat e ardhshëm, nëse ligjet dhe rregulloret për mbrojtjen e faunës ujore dhe habitateve të tyre nuk zbatohen. Kuadri ligjor shqiptar, përmes Ligjit Nr. 64/2012 për Peshkimin (i ndryshuar), shërben si baza rregullatore për menaxhimin e aktiviteteve të peshkimit dhe përcakton qartë rregullat, procedurat, institucionet përgjegjëse, aktivitetet e paligjshme dhe shkeljet administrative. Për më tepër, ky ligj ka si qëllim mbrojtjen e burimeve detare dhe ujërave të brendshme, menaxhimin e qëndrueshëm të peshkimit dhe fuqizimin e komuniteteve në proceset vendimmarrëse.

Ky libërth është përgatitur për të ndarë me publikun e gjerë diversitetin e peshqve në lumin Buna, përmes informacioneve të shkurtra dhe imazheve të llojeve. Gjithashtu, informacione si kuadri ligjor, sezoni i peshkimit, statusi i kërcënimit të peshqve, etj., do të jenë ndihmë e madhe për institucionet përkatëse për të ruajtur zonën dhe për të parandaluar peshkimin e paligjshëm.

Peizazhi i Mbrojtur Lumi i Bunës-Velipojë

Kompleksi ligatinor lumi i Bunës-Velipojë, i cili përfshin lumin Buna, grykëderdhjen e lumit Drin, si dhe zonën bregdetare të Velipojës, është shpallur si Peizazh i Mbrojtur (kategoria e V-të) në vitin 2005. Kjo Zonë e Mbrojtur përfshin një territor prej 21,678.85 ha dhe është e vendosur në fushën e nën Shkodrës, në pjesën jugore të Ultësirës së Shkodrës. Ky kompleks paraqet një ndërtim gjeologjik të përbërë nga shkëmbinjtë gëlqeror, flish, etj. Kjo larmi është kushtëzuar nga pozicioni ku ndodhet fusha e nën Shkodrës, pasi është e ndërtuar në takimin e katër zonave tektonike: atë të Alpeve, Mirditës, Krasta-Cukalit dhe Krujës. Për shkak të pozicionit gjeografik të Shqipërisë, klima e PM Lumi i Bunës-Velipojë është tipike mesdhetare. Ajo karakterizohet nga një dimër i butë e i lagësht dhe me verë të thatë. Gjithashtu, influenza e bregdetit zbut thatësinë karakteristike mesdhetare. Në rrjedhën e poshtme formon një kompleks ligatinor si Liqeni i Shalsit, kënetat e Mertemzës, Domnit, Velipojës dhe Laguna e Vilunit. Ndërsa përgjatë lumit janë të formuar disa ishuj që gjenden të shpërndarë në pjesë të ndryshme të tij.

Përsa i përket sedimenteve, ata kanë ndikuar në krijimin e mjaft habitateve të rëndësishëm, kjo ndihmuar edhe nga Drini që furnizon Bunën me materiale aluvionale. Materialet e mëdha depozitohen në fund të shtratit të lumit, kryesisht në rrjedhjen e sipërme të tij. Sedimentet aluvionale që sjell Buna janë kryesisht zhavor, rërë dhe argjilë. Duhet përmendur se Buna ka një rrjedhje mesatare të sedimenteve të cilat i transporton në formë suspensioni ose të lëngshme: në suspesion janë 438 kg/sek, ndërsa në turbullirë prurjet arrijnë deri në 1250 gr/ m³.




Figura nr.1: Hartë e Zonës së Mbrojtur Lumi Buna-Velipojë dhe Liqeni i Shkodrës kandidate për zonë ***Emerald***. Punuar nga E. Gjyzeli.

Dy zona të tjera me rëndësi ekologjike janë:

Këneta me ujë të ëmbël e Domnit që përfshin një zonë të konsiderueshme me kallamishte (*Phragmites australis*), e vendosur përgjatë rrugës nga Shkodra në Velipojë.

Laguna e Vilunit që përmban ujë të kripur, ndodhet në distancë prej 2 km në lindje të plazhit të Velipojës. Laguna komunikon me detin me anë të një kanali të gjatë prej rreth 500 metrash.






Shumëllojshmëria biologjike

Kjo Zonë e Mbrojtur dallohet për shumëllojshmërinë biologjike për bimët, shpendët, gjitarët dhe peshqit që gjenden në të. Formacionet bimore me plep të bardhë (*Populus alba*), vërriuin e zi (*Alnus glutinosa*), marinën lulevogël (*Tamarix parviflora*) apo me shelgun e bardhë (*Salix alba*), shërbejnë si habitate për mjaft shpendë. Disa nga llojet që mund të përmendim janë: karabullakët, pulëbardhat, rosat, bajzat apo çafkat, etj. Në zonë janë vëzhguar edhe gjurmët e një prej gjitarëve më të rrezikuar në botë, ato të lundrës (*Lutra lutra*). Peshqit gjithashtu, janë një klasë mjaft e rëndësishme që gjenden në këtë Zonë të Mbrojtur dhe veçanërisht të lumit Buna. Ky lum merr një rëndësi të madhe, pasi shërben si segmenti përfundimtar që lidh sistemin hidrologjik të Drinit me detin Adriatik. Kështu, shërben si korridor ekologjik për peshq që shtegtojnë për në Adriatik nga liqenet e Prespës, liqenit të Ohrit dhe atij të Shkodrës.

Peshqit



Peshqit janë gjallesa vertebrorë ujorë që përdorin velëzat për frymëmarrje, jo mushkëritë. Gjithashtu, ata nuk kanë gjymtyrë si këmbë apo gishtërinj. Termi “peshq” i referohet një grupi shumë të larmishëm gjallesash, të cilët janë të shpërndarë në të gjithë botën dhe jetojnë në të gjitha llojet e trupave ujorë.

Duke qenë se peshqit përbëjnë një grup shumë të madh, ata paraqiten në forma dhe përmasa të ndryshme. Përsa i përket përmasave, ato variojnë nga peshku më i vogël, *Paedocypris progenetica* (një lloj ciprinidi), me gjatësi prej vetëm 7.9 mm, deri te një lloj peshkaqeni, *Rhincodon typus*, që arrin deri në 12 metra.

Peshqit kanë një dietë shumë të larmishme, e cila përfshin peshq të tjerë, bimë, krustace, krimba, molusqe, insekte dhe larvat e tyre, amfibë dhe plankton. Me një ndërtim kompleks të trupit, peshqit karakterizohen përgjithësisht nga prania e pendëve (ndonëse disa lloje, si ngjala, nuk kanë të gjitha çiftet e pendëve), luspave ose formacione të tjera që ju mundësojnë të ushqehen dhe të mbrohen nga grabitqarët.

Vija anësore që përshkon trupin e një peshku është një komponent mjaft i rëndësishëm pasi ndihmon peshkun të ndiejë lëvizjet e dobëta në ujë dhe gradientin e përqëndrimit. Për sa i përket shpërndarjes së tyre biogjeografike, peshqit klasifikohen gjerësisht bazuar në shpërndarjen e tyre gjeografike dhe tolerancën ndaj kripësisë: peshq të ujërave të embla dhe peshq detarë. Në çdo rast, peshqit nga të dy grupet shtegtojnë drejt ujërave të embla ose të kripura për të lëshuar vezët, ushqim ose strehim. Këto cilësi i bëjnë peshqit një grup unik në botën e gjallë, duke luajtur një rol të rëndësishëm në zinxhirin ushqimor dhe ekosistemet ujore duke ndikuar në bollëkun, madhësinë, strukturën dhe produktivitetin e zooplanktonit ose fitoplanktonit, të cilët janë në fillim të këtij zinxhiri.

Problematikat kryesore që rrezikojnë peshqit

Lumi i Bunës, për shkak të karakteristikave hidrologjike dhe habitateve që ka formuar, shërben si një ndër ekosistemet më të rëndësishme për peshqit. Lloje si blini i bardhë, që kërkon trupa ujorë me rrjedhje të forta kanë gjetur kushtet e përshtatshme edhe për t'u shumuar. Madje, realizon edhe ciklin e plotë jetësor në këtë lum. Në Bunë gjenden edhe llojet e liqenit të Shkodrës, për shkak të klimës së ngjashme me të. Pikërisht, kjo shumëllojshmëri ka shërbyer përgjatë historisë si burim ushqimi edhe për njerëzit. Ndërsa sot, peshkimi përbën një sektor të rëndësishëm të ekonomisë së zonës së Shkodrës.

Por, për shkak të praktikave të gabuara dhe të shfrytëzimit pa kriter shumë lloje janë momentalisht të kërcënuara për zhdukje dhe disa lloje të tjera mendohen të zhdukura pasi nuk janë parë prej një kohe të gjatë në lum. Kështu, dy lloje mjaft kritike për ekosistemin ujor: blini i bardhë (*Acipenser naccarii*) dhe blini (*Acipenser sturio*)

nuk janë parë që prej 10 vitesh në Lumin e Bunës. Kjo u vërtetua dhe nga studimi që realizoi PPNEA. Ndërsa një lloj tjetër si ngjala (*Anguilla anguilla*) është në rrezik kritik për zhdukje.

Një tjetër praktikë e gabuar është futja e llojeve (induktim) nga vende të tjera dhe që nuk i takojnë Shqipërisë, kryesisht për qëllime ekonomike. Kjo lloj praktike që mund të duket e mirë, pasi mund të sjellë përfitime në sektorin e peshkimit, shoqërohet me pasoja natyrore dhe ekonomike. Disa lloje që induktohen nuk mund të arrijnë të përshtaten dhe mund të zhduken, duke shkaktuar kështu humbje ekonomike. Këto lloje të cilat konsidoren aliene, përshtaten shumë mirë me kushtet aktuale, duke u ndihmuar edhe nga ndryshimet klimatike dhe ndotja. Në këtë mënyrë ato konkurojnë edhe llojet vendase, duke shfaqur veti invazive (pushtuese). Raporti nxorri që peshku mushkonjë (*Gambusia holbroki*) është lloj invaziv dhe që rrezikon seriozisht ekzistencën e llojeve vendase.

Peshkimi i paligjshëm

Të gjitha format e peshkimit, të cilat janë të ndaluara dhe mos respektimi i sezoneve të peshkimit ndikojnë negativisht në ruajtjen e popullateve të peshqve. Peshkimi pa kriter sjell pasoja të parikuperueshme të sasia e stokut të peshkut.

Braktisja ose hedhja e materialeve të peshkimit në ujë

Ky fenomen negativ ka një ndikim të madh ekologjik, pasi aty mund të ngecin peshq, lloje të tjera ujore ose shpendë, dhe nga pamundësia për të dalë mund të shkaktohet ngordhja e tyre. Po ashtu, hedhja e mbetjeve dhe inerteve paraqet një kërcënim për peshqit.

Shkarkimi i ujërave të zeza dhe ato bujqësore

Këto shkarkime rrisin nivelin e fosforit dhe të azotit, duke shkaktuar një zhvillim të madh të algave. Këto alga zvogëlojnë nivelin e oksigjenit, duke shkaktuar edhe ngrodhjen e peshqve ose rritjen e nivelit të këtyre komponimeve në organet e peshqve, të cilët kalojnë më pas tek njeriu.


Marrja e interteve

Praktika e marrjes së inerteve, si zhavorri nga shtrati i lumit të Bunës, ka shkatërruar dhe po vazhdon të shkatërrojë habitatet e peshqve, të cilët nuk do të jenë në gjendje të riprodhohen ose të gjejnë ushqim. Kjo sjell pasoja negative për të gjithë ekosistemin dhe për banorët e tjerë të lumit dhe më gjerë.

Duhet theksuar se të gjithë faktorët e përmendur më sipër nuk ndikojnë vetëm në kërcënimin e peshqve, por edhe të gjallesave të tjera, si shpendët ose gjitarët që ushqehen me peshq, etj.. Peshqit shërbejnë gjithashtu si bioindikatorë të cilësisë së ujit, duke treguar nëse gjendja është e mirë ose e keqe.

Prandaj, në këto kushte, lind nevoja për të mbrojtur peshqit dhe për të zbatuar një peshkim të qëndrueshëm. Por, çfarë është një peshkim i qëndrueshëm?

Me fjalë të thjeshta, është të lësh mjaftueshëm peshk dhe të minimizosh ndikimet në habitatet dhe ekosistemet e tyre. Prandaj, duhet respektuar sezonet e peshkimit, të mos përdoren rrjeta që shkatërrojnë habitatet e peshqve dhe të mos braktisen rrjetat dhe materialet e peshkimit. Në nivel organizativ, duhet të merren masa për parandalimin e shkarkimeve të ujërave të zeza në lumenj dhe të ndalohet marrja e inerteve pa kriter.



Duke përdorur një peshkim sipas standardeve dhe duke ruajtur natyrën, ne vendosim bazat për një të ardhme të qëndrueshme për jetën tonë dhe për mbrojtjen e natyrës, duke i përdorur shërbimet e ekosistemit me përgjegjësi.

Simbole / Legjenda

Gj - Gjatësia

P - Pesha

SB - Statusi në nivel botëror (*Sipas Unionit Ndërkombëtar të Ruajtjes së Natyrës - IUCN*).

An aerial photograph of a river delta, likely the Buna River, showing a network of water channels and lush green islands. A teal semi-transparent box is overlaid on the left side of the image, containing text in Albanian. The text describes the family Acipenseridae, which includes sturgeons, and mentions their presence in the Buna River and its delta. The text is in a serif font, with the family name in italics.

Familja *Acipenseridae*

Kjo është një familje e vogël e kufizuar vetëm në hemisferën veriore.

Pjesa më e madhe e blinorëve janë lloje anadrome, që ushqehen në ujëra detare ose në ujëra të embla dhe ndërmarrin udhëtime të gjata për të lëshuar vezët në lumenj të mëdhenj. Një nga habitatet e tyre të rëndësishëm është edhe lumi i Bunës. Këta peshq gjithashtu janë të aftë për të realizuar ciklin e tyre jetësor në ujëra të embla. Blinorët janë peshq kryesisht me trup të madh, pa luspa dhe me 4 mustaqe (barbela). Nga të gjitha familjet e peshqve të ujërave të embla në Evropë, është familja më e ndikuar nga aktiviteti njerëzor për shkak të mbipeshkimit dhe ndërtimit të hidrocentraleve. Këta faktorë kanë shkaktuar zhdukjen e tyre në shumë vende.

Blini i bardhë (*Acipenser naccari*)

Ky është një lloj endemik i detit të Adratikut dhe i degëve e tij. Në Shqipëri prezenca e tij është e dokumentuar vetëm në lumin e Bunës. Zhdukja e blinit të bardhë në lumin e Bunës erdhi si rezultat i mbipeshkimit, ndotjes dhe humbjes së habitateve.

Ai karakterizohet nga një trup i gjatë, me pjesën kurrizore në ngjyrë gri në kafe, kurse pjesa anësore është më e zbehtë dhe ajo barkore është e bardhë. Ky lloj peshku preferon lumenjtë e mëdhenj dhe të thellë me rrjedhë të fortë, qëndron afër lagunave dhe afër grykëderdhjeve të lumenjve, kryesisht me substrat me baltë dhe rërë në një thellësi prej 10-40 metra.



Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 2 m **P:** 25 kg.

SB: *I rrezikuar në mënyrë kritike (CR)*

Kërcënimet: *Mbipeshkimi, ndotja, shkatërrimi i habitateve.*

Blini (*Acipenser sturio*)

Një tjetër lloj i familjes *Acipenseridae*, blini ka një shpërndarje më të gjerë në krahasim me blinin e bardhë. Ky i fundit gjendet i përhapur në Atlantikun Lindor, ndërsa në Shqipëri në disa nga lumenjtë e vendit. Kurrizi paraqitet me ngjyrë nga gri në kafe dhe blu e errët e të bardhë në pjesën barkore.



Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gjmax: 5 m **Pmax:** 400 kg.

SB: *I rrezikuar në mënyrë kritike (CR)*

Kërcënimet: *Mbipeshkimi, shkatërrimi i habitateve.*

Familja *Anguillidae*

Kjo familje karakterizohet nga lloje peshqish të cilët dallohen për trupin e tyre të zgjatur dhe pendët kurrizore, të bishtit dhe ato anale që janë të gjata dhe të bashkuara. Tek këto lloje mungon penda e barkut. Ata shtegtojnë nga lumi në det për të depozituar vezët. Ngjالات ndodhen në të gjithë oqeanet e botës. Në Shqipëri, përfaqësuesi i kësaj familje është vetëm ngjala (*Anguilla anguilla*).

Ngjala (*Anguilla anguilla*)

Ngjala është një nga llojet më karizmatike të peshqve, e njohur për udhëtimin e saj për t'u ripordhuar në detin e Sagraseve. Ngjala karakterizohet nga një ngjyrë e argjendtë dhe nga një trup i gjatë dhe cilindrik. Ajo gjendet në disa mjedise ujore, duke përfshirë ujërat e kripura, ato të embla dhe të njelmëta. Preferon thellësitë dhe zakonisht gjendet në fund të shtratit të lumenjve.



Sezoni i peshkimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 130 cm **P:** 7 kg.

SB: I rrezikuar në mënyrë kritike (CR)

Kërcënimet: Mbipeshkimi, shkatërrimi i habitateve dhe ndërtimi i HEC-ve që bllokojnë shtegtimin e tyre.

Familja *Atherinidae*

Kjo familje përfshin peshq me trup të vegjël dhe të mesëm që gjenden në dete tropikale dhe të tempëruar.

Këta peshq karakterizohen nga një trup i zgjatur dhe i shtypur me ngjyrë të argjendtë, dhe kanë dy pendë kurrizore të ndara. Janë tolerantë ndaj niveleve të ndryshme të kripshmërisë, duke bërë që të kenë përshtashmëri të lartë në mjedise të ndryshme ujore.

Aterina symadhe (*Atherina boyeri*)



Ky është një lloj vendas në Lumin e Bunës. Këtë peshk mund t'a gjejmë përgjatë gjithë detit Mesdhe. Paraqitet me ngjyrë kafe dhe argjendi dhe me kurrizin në kafe të errët. Preferon të qëndrojë në ujëra bregdetarë dhe grykëderdhje, por edhe në rrjedha siç janë lumenjtë dhe sistemet ligatinore.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 20 cm **P:** 4-5 kg.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Shkatërrimi i habitateve dhe ndotja.

Familja *Nemacheilidae*

Kjo familje përbëhet kryesisht nga peshq të vegjël që gjenden në Evropë dhe Azi. Karakteristikë dalluese e llojeve është prania e 3 palë mustaqeve. Llojet e kësaj familje jetojnë në ujëra të embla dhe preferojnë rrjedha me ujë të freskët dhe të mirë oksigjenuar. Disa prej tyre janë të njohura dhe të përdorura si lloje akvariumi.

Gurnecka e Zetës (*Barbatula zetensis*)

Ky është një lloj vendas që popullon lumin e Bunës dhe është i pranishëm në liqenin e Shkodrës. Ky lloj paraqitet me ngjyrë argjendi të zbehtë dhe me njolla kafe të errëta në pjesën kurrizore. Preferon të jetoj në lumenj apo përrenj me funde të forta me zhavorr ose me gurë.



Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 6-7 cm **P:** 200 g.

SB: I përkeqësuar (VU)

Kërcënimet: Mbipeshkimi dhe shkatërrimi i habitateve.

Familja *Blennidae*

Kjo është një familje e madhe dhe përfshin më së shumti peshq detarë me trupa të vegjël.

Llojet e kësaj familje gjenden në të gjithë botën, në detet tropikale dhe ato të tempëruar, sidomos në ujëra të cekta. Disa lloje janë përshtatur të jetojnë në ujëra të embla.

Karakteristikë dalluese është prania e një spine të vetme dhe mungesa e luspave.



Blenidi i ujërave të embla (*Salariopsis fluviatilis*)

Lloj vendas në lumin e Bunës. Atë e gjejmë të pranishëm në përrenj, lumenj dhe liqene. Karakterizohet nga ngjyra kafe e zbehtë ose e verdhë me disa shirita të errët.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 15 cm **P:** 400 g.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Shkatërrimi i habitateve.

Familja *Petromyzontidae*

Peshqit e kësaj familje janë ngjalë-ngjashëm me 7 velëza të rrumbullakta që hapen mbrapa syrit. Tek këta peshq mungojnë çiftet e pendëve dhe luspat.

Llojet në këtë familje dallohen nga një disk gojor shumë karakteristik. Janë lloje anadrome që pasi lëshojnë vezët në det, shtegtojnë në rrjedhën e sipërme të lumenjve. Jetojnë në mjedise detare me rërë dhe në sedimente argjilore në ujëra të embla.



Lampetra soljani

Ky lloj është një lloj vendas në lumin e Bunës. Ai preferon mjedise me ujë të embël dhe fundet e lumenjve me klimë subtropikale. Ky lloj paraqitet në pjesën kurrizore me ngjyrë kafe dhe në pjesën barkore me një ngjyrë më të zbehtë.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gjmax: 12.6 cm

P: 30 g.

Kërcënimet: Ky lloj nuk është i kërcënuar.

Familja *Centrarchidae*

Kjo familje e vogël që përmban rreth 30 lloje peshqish janë vendas në Amerikën e Veriut që nga Alaska deri në Meksikë. Në Evropë janë introdiktuar 6 lloje nga kjo familje. Këta peshq janë futur dhe në mënyrë aksidentale në pellgje apo liqene, por mund të mbijetojnë vetëm për disa vite. Llojet e kësaj familje dallohen nga lloje të tjera të induktuara, pasi si karakteristikë kanë një vijë anësore të vazhduar dhe një pendë të vetme kurrizore.

Peshku farëkungull (*Lepomis gibossus*)

Ky lloj është i induktuar në lumin e Bunës. Karakterizohet nga një trup i madh dhe i ngjeshur anash. Pjesa anësore e këtij peshku paraqitet me ngjyrë të verdhë në të gjelbër dhe me praninë e njollave të shndritshme me të njëjtën ngjyrë në të gjithë trupin. Preferon habitate me ujëra të freskëta dhe të ngrohta.



Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 20 cm

P: 300 g.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Ndotja urbane dhe shkarkimet e ujërave të zeza, një fenomen negativ në lumin e Bunës.



Familja *Cobitidae*

Një familje, kryesisht, e peshqve të vegjël dhe të hollë që ka një shpërndarje të gjerë duke filluar nga Evropa, në Azi dhe në Afrikë, vetëm në Maroko.

Llojet e kësaj familje dallohen nga një shtyllë kurrizore e rrotulluar, e lëvizshme dhe e bigëzuar, e cila është e fshehur nën lëkurë tek shumë prej tyre. Ata karakterizohen nga një trup i zgjatur dhe jetojnë në pjesën e fundme të lumenjve. Llojet janë shumë të ngjashme nga pamja e jashtme, por që ndryshojnë gjenetikisht.



Gurnecka e Ohrit (*Cobitis ohridana*)

Lloj endemik që gjendet në lumenj si Buna, Drini dhe Vjosa, si dhe në liqenet e Shkodrës dhe të Ohrit. Ky peshk preferon mjedise me ujë të embël dhe të tempëruar. Paraqitet me ngjyrë kafe dhe me njolla të zeza në pjesën kurrizore.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gjmax: 6.9 cm **P:** 2-3 gr.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Ndotja dhe shkatërrimi i habitateve.

Gurnecka me gjëmbe e Ballkanit (*Sabanejewia balcanica*)



Ky është lloj vendas që gjendet në lumin e Bunës. Ai preferon mjedise ujore të embla dhe të njelmëta me temperatura të buta. Karakterizohet nga ngjyra e zezë dhe kafe në gri.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12


Gj: 9 cm **P:** 12g.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Shkatërrimi i habitateve.

Familja *Citharidae*

Janë një familje e vogël me katër gjini që gjenden të shpërndarë në Detin Mesdhe, në Oqeanin Indian, në Japoni deri në Australi. Nga 5 gjinitë, vetëm gjinia *Citharus* gjendet në Mesdhe. Kjo familje përmban vetëm 7 lloje peshqish, të cilët karakterizohen nga një trup në formë vezake dhe të sheshtë. Ajo që i dallon nga grupet e tjera është trupi i ngjeshur dhe vendosja e syve në një anë. Preferojnë të qëndrojnë në fundin e trupave ujorë të mbuluar me baltë ose rërë. Vezët i lëshojnë në det, por shpesh edhe në grykëderdhjen e lumenjve.



Paroshja (*Citharus linguatula*)

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Ky është një lloj vendas në lumin e Bunës, që preferon mjedise ujore me thellësi të mëdha. Ai gjendet, kryesisht, në funde të mjediseve detare. Karakterizohet nga ngjyra kafe e zbehtë.

Gj: 15 cm **P:** 150 g

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Mbipeshikimi dhe shkatërrimi i habitateve.

Familja *Cyprinidae*

Një nga familjet më të mëdha të peshqve të ujrave të embla, që gjendet pothuajse në të gjithë botën, përveçse në Madagaskar, Zelandën e Re, Australi dhe Amerikën e Jugut. Kjo familje përmban më shumë se 2100 lloje me përmasa dhe forma të larmishme.

Këta lloje dallohen nga një “dhëmb” që gjendet në pjesën e fytyrës, i quajtur dhëmbi faringial. Gjithashtu i gjejmë në habitate duke filluar nga pellgje të vegjël dhe deri tek përrenjtë që gjenden në Himalaja.

Nga kjo familje kaq e madhe në lumin e Bunës gjenden lloje vendase, endemike dhe të indoktuara.

Barkëgjera e Ohrit (*Alburnoides ohridanus*)



Ky është një lloj endemik që gjendet në liqenin e Ohrit. Preferon mjedise me ujëra të embla dhe të njemëlta, prandaj lumi i Bunës ofron habitate të rëndësishme për të. Karakterizohet nga ngjyra e verdhë dhe blu e hapur në pjesën kurrizore.

Sezoni i shumimit:


1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 9 cm

P: 10-15 g

SB: I përkeqësuar (VU)

Gjuca e Shkodrës (*Alburnus scoranza*)



Ky është një lloj endemik që gjendet në liqenin e Shkodrës dhe atë të Ohrit, i pranishëm edhe në lumin e Bunës dhe të Drinit. Preferon mjedise ujore me ujë të ëmbël dhe të tempëruar. Paraqitet me ngjyrë të gjelbër dhe kafe.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12


Gj: 18 cm

P: 47 g.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Shkatërrimi i habitateve.

Kubla liqenore (*Alosa fallax*)



Sezoni i peshkimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Kubla liqenore është një lloj vendas në lumin e Bunës dhe karakterizohet nga ngjyra e argjendtë dhe blu në pjesën kurrizore. Atë e gjejmë të pranishme në mjedise ujore të kripuara dhe të embla.

Gj: 40 cm

P: 1.5 kg

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Praktikat e gabuara të peshkimit, ndotja dhe llojet invazive.

Grunci i karsteve (*Phoxinus phoxinus*)



Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Ky është lloj vendas që gjendet në lumin e Bunës. Nodhet në mjediset me ujëra të embla e të njelmëta dhe preferon fundet e tyre. Karakterizohet nga ngjyra kafe në të zezë në pjesën kurrizore dhe të argjendtë në pjesën barkore të shëndritshme.

Gj: 7 cm

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Ndotja.



Krap (*Cyprinus carpio*)

Sezoni i peshkimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 60 cm

P: 4 kg.

Kërcënimet: Ky lloj nuk është i kërcënuar.

Ky është një lloj i induktuar në lumin e Bunës.

Karakterizohet nga një trup i madh dhe i gjatë, me ngjyra që variojnë nga jeshile në të verdhë, kafe e errët dhe deri në argjend. Ai preferon trupa ujorë të mëdhenj me rrjedhje të ngadaltë dhe sedimente të buta.

Karasi Prusian (*Carassius gibelio*)



Ky është një lloj i induktuar në lumin e Bunës. Ai gjendet në mjedise me ujëra të ëmbël dhe të njelmëta dhe karakterizohet nga ngjyra e argjendtë në kafe.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12


Gj: 20 cm

P: 3 kg.

Kërcënimet: Ky lloj nuk është i kërcënuar.

Karasi i artë (*Carassius auratus*)

Karasi i artë është një lloj i induktuar në lumin e Bunës. Preferon kryesisht ujëra të rrjedhshëm kontinental apo laguna. Janë të prirur të jetojnë në ujëra të qetë ose pa lëvizje, siç mund të jenë lumenjtë, liqenet, pellgjet, përrënjtë, kënetat, etj. Ka varietet me kombinim ngjyrash, si të bardha, të verdha, të kuqe, etj. Shfaq veti pushtuese (invazive) dhe konkurrese ndaj llojeve të tjerë.



Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 10 cm

P: 6 kg.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Ndotja.

Njila e Ohrit (*Chondrostoma ohridanus*)



Njila e Ohrit është një lloj endemik që gjendet në lumin e Bunës. Preferon mjedisë kryesisht me ujëra të embla dhe gjendet gjithashtu në lumin e Drinit dhe në liqenet e Shkodrës dhe atë të Ohrit. Karakterizohet nga një ngjyrë blu në gri metalike.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 25 cm

P: 1.5 kg.

SB: Afër Rrezikimit (NT)

Kërcënimet: Ndotja dhe shkatërrimi i habitateve.

Mlyshi i Drinit (*Squalius platyceps*)



Një lloj endemik që gjendet në lumin e Bunës, i raportuar edhe në lumin e Drinit, në liqenet e Shkodrës dhe Ohrit. Ky lloj preferon mjedise me ujë të ëmbël të temperuar. Karakterizohet nga ngjyra argjendi dhe kafe.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 47.2 cm **Pmax:** 1.2 kg.

SB: Rrezik i ulët (LR)

Kërcënimet: Shkatërrimi i habitateve dhe ndotja.

Skorti i bardhë (*Rutilus albus*)



Është një lloj vendas që gjendet në lumin e Bunës, gjithashtu gjendet edhe në liqenin e Shkodrës. Emri “albus” rrjedh nga latinishtja që do të thotë e bardhë. Trupi i tij paraqitet nga një ngjyrë e bardhë e argjendtë, karakteristike për këtë lloj. Gjendet në mjedise me ujë të ëmbël dhe të temperuar.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gjmax: 29.5 cm

Pmax: 98.5 g

Kërcënimet: Ky lloj nuk është i kërcënuar.



Skorti i Prespës, Pllotica (*Rutilus prespensis*)

Sezoni i peshkimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gjmax: 23.3 cm

P: 180 gr.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Shkatërrimi i habitateve.

Është një lloj edemik i Adratikut që gjendet edhe në lumin e Bunës. Paraqitet me një trup të zgjatur dhe mesatar me ngjyrë të argjendtë. Gjendet në një gamë të gjerë habitatesh si përrenj dhe lumenj me rrymë mesatare dhe të ngadaltë, liqene, kënetë, rezervuare, etj.

Skorti i zi, Skorti i Ballkanit (*Pachychilon pictum*)



Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Një lloj endemik i cili gjendet duke filluar nga lumi i Drinit deri në lumin e Vjosës. Ky lloj paraqitet me ngjyrë argjendi dhe njolla të zeza në pjesën kurrizore. Preferon mjedise me ujë të ëmbël dhe me klimë të ngrohtë.

Gj: 18 cm

P: 70 gr.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Shkatërrimi i habitateve dhe ndotja.

Idhtaku (*Rhodeus amarus*)



Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Lloj i induktuar në lumin e Bunës. Preferon ujëra të qetë ose pa lëvizje dhe me prani të lartë bimësie. Ky peshk paraqitet me ngjyrë të gjelbër, argjendi dhe të kaltër.

Gj: 10 cm

P: 7 gr.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Shkatërrimi i habitateve dhe ndotja.

Notaku (*Pseudorasbora parva*)



Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Lloj i introduktuar në lumin e Bunës, notaku është peshku që parapëlqen mjedise ujore me bimësi të zhvilluar. Atë e gjejmë kryesisht në zona të tilla si kanale të vegjël, pellgje dhe liqene kryesisht të vegjël. Ngjyra e trupit, varion nga jeshile në të verdhë deri në të artë, ku mashkulli paraqitet më i zbehtë.

Gj: 8 cm

P: 19 gr.

Kërcënimet: Ky lloj nuk është i kërcënuar.

Amuri i bardhë (*Ctenopharyngodon idella*)



Amuri i bardhë është një peshk i madh, që është induktuar në lumin e Bunës. E gjejmë në mjedise me ujëra të njelmëta dhe të embla. Paraqitet me një variueshmëri ngjyrash të verdhë në të gjelbër deri në kafë të errët dhe të bardhë.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 60 cm

P: 25 gr.

Kërcënimet: Ky lloj nuk është i kërcënuar.

Ballëgjeri i bardhë (*Hypophthalmichthys nobilis*)



Ballëgjeri i bardhë është një lloj i induktuar në lumin e Bunës. Ka një ngjyrë të murrme dhe njolla të zeza në pjesët anësore. Karakteristikë është goja e madhe, pa mustaqe (barbeles) dhe pa dhëmbë. Preferon habitate të tilla, si sisteme lumore, bashkime rrjedhash të liqeneve, rezervuare, etj. Mund të tolerojnë temperatura të larta të ujit.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 150 cm

Pmax: 50 kg.

Kërcënimet: Ky lloj nuk është i kërcënuar.

Ballëgjeri larosh

(*Hypophthalmichthys molitrix*)



Ballëgjeri larosh është lloj i induktuar në lumin e Bunës, i cili preferon mjedise me ujë të njelmt dhe të ëmbël. Paraqitet me ngjyrë të argjendtë të theksuar dhe duke u rritur karakterizohet nga një ngjyrë e gjelbër e zbehtë në pjesën kurrizore.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gjmax: 120 cm

Pmax: 50 gr.

Kërcënimet: Ky lloj nuk është i kërcënuar.

Pëllëmbëza

(*Megalobrama terminalis*)



Ky peshk është një lloj i induktuar në lumin e Bunës, i cili preferon mjedise me ujëra të embla.

Karakterizohet nga një ngjyrë e argjendtë.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 20 cm

P: 4 kg.

Kërcënimet: Ky lloj nuk është i kërcënuar.

Krapi i zi (*Mylopharyngodon piceus*)



I induktuar në lumin e Bunës, atë e gjejmë të pranishëm në lumenj, përrenj dhe liqene. Ky lloj kërkon lumenj të mëdhenj për t'u riprodhuar. Karakterizohet nga ngjyrë e zezë, kafe dhe e kaltër e errët.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 60-100 cm

P: 45 kg.

Kërcënimet: Ky lloj nuk është i kërcënuar.

Lloska e Shkodrës (*Scardinius knezevici*)



Është një lloj endemik që gjendet në liqenet e Ohrit dhe atë të Shkodrës. Atë e gjejmë në mjedise ujore të embla dhe të tempëruara. Paraqitet me ngjyrë të argjendtë deri në portokalli.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12


Gj: 29.5 cm

Pmax: 364 g.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Shkatërrimi i habitateve.

Skorti me vizë (*Telestes montenigrinus*)



Është endemik i liqenit të Shkodrës dhe lumit të Bunës. Preferon mjedise me ujëra të ëmbëla dhe me rrjedhje të qetë. Karakterizohet nga ngjyra kafe e errët dhe e argjendtë.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 10 cm

P: 10 gr.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Shkatërrimi i habitateve.

Lina (*Tinca tinca*)



Lina është një lloj i induktuar në lumin e Bunës. Karakterizohet nga një trup i gjatë. Trupi ka ngjyrë të gjelbër të errët në të verdhë të ndritshme. Banon në ujëra me rrjedhje të qetë dhe të tempëruar, ku janë të pranishme bimë ujore.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 70 cm

P: 7.5 kg.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Shkatërrimi i habitateve.

Familja *Gasterosteidae*

Gasterosteidae është një familje e vogël me 5 gjini dhe me rreth 15 lloje peshqish që gjenden në ujëra të embëla dhe bregdetare, që nga Euroazia deri në Amerikën e Veriut.

Ajo që i dallon këto lloje është prezenca e një serie luspash në pendën dorsale, luspë teke në pendën anale, si dhe një çift i pendëve pelvike.

Llojet e kësaj familje janë të njohura për ndërtimin e foleve, të cilat përbëhen nga mbeturina bimore dhe alga. Foleja mbahet e lidhur nga fije që shërbejnë si substrat ose të mbështetura në bimësi. Mashkulli tërheq femrën në fole, në të cilën vezët janë gati për t'u fertilizuar. Foleja ruhet nga mashkulli dhe më vonë nga juvenilët.

Trigjilpërëza (*Gasterosteus acuelatus*)

Ky është një lloj vendas që gjendet në lumin e Bunës. Jeton në ujëra të embëla dhe të njelmëta. Habitatet tipike për të janë trupat ujqor me rrjedhje të qetë dhe me ujë të pastër, me fund ranor dhe të pasur me bimësi. Paraqitet me ngjyrë të bardhë dhe argjendi.



Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 8 cm

P: 10 g.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Shkatërrimi i habitateve.


Familja *Gobidae*

Një familje e madhe që përmban rreth 2000 lloje, që janë më së shumti detarë me shpërndarje në të gjithë botën, me larmi më të madhe në ujërat detar tropikal.

Kurse në Evropë, shumëllojshmëria më e madhe ndodhet në Detin Mesdhe, Detin e Zi dhe në atë të Kaspikut.

Janë në përgjithësi peshq me trup të vogël të cilët popullojnë mjedise ujore detare të njelmëta, po disa gjenden edhe në ujëra të embla. *Economidichthys trichonis* është peshku më i vogël, që gjendet në ujëra të embla në Evropë.

Peshqit e kësaj familje dallohen nga llojet e tjera të ujërave të embla, pasi kanë pendët e barkut të bashkuara për të formuar një organ thithës me një membranë tërthore të përparme.



Njëmustakori i Shkodrës (*Gobio skaderensis*)



Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Njëmustakori i Shkodrës, nga vetë emri është një lloj endemik që gjendet në liqenin e Shkodrës dhe në lumin e Bunës. Atë e gjejmë në mjedise me ujëra të embla dhe të njelmëta. Karakterizohet nga një ngjyrë e gjelbër dhe e argjendtë.


Gj: 12 cm

Pmax: 220 gr.

SB: I rrezikuar (EN)

Kërcënimet: Shkatërrimi i habitateve dhe mbishfrytëzimi.

Burdullaku i Shkodrës (*Pomatoschistus montenegrensis*)



Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Është një lloj endemik i liqenit të Shkodrës. Ngjyra e trupit varion nga gri në kafe. Preferon lumenj të cekët dhe pellgje me shtresa zhavorri, në të cilat rriten alga, që i shërbejnë këtij peshku për t'u mbrojtur nga grabitqarët.

Gjmax: 2.8 cm

P: 10 gr.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Fragmentimi i habitateve dhe ndotja.

Familja *Ictaluridae*

Kjo familje është endemike dhe gjendet nga Amerika Veriore deri në Amerikën Jugore, duke përfshirë Guatemalën. Ajo përfshin rreth 50 lloje të grumbulluara në 6 gjini. Dallohen nga llojet e tjera evropiane për shkak të pendëve që janë të dhjamosura.

Peshku kokëviç kafe (*Ameiurus nebulosus*)

Ky është një lloj peshku i induktuar në lumin e Bunës, i cili gjendet i përhapur në trupa ujorë me rrjedhje të ngadalta të përrenjve, lumenjve, rezervuarëve dhe liqeneve. Janë lehtësisht të përshtatur, pasi tolerojnë një gamë të gjerë të kushteve mjedisore. Paraqitet me ngjyrë kafe të errët në jeshile.



Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 2-3 cm **P:** 5 g.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Ndotja dhe degradimi i habitateve.

Familja *Moronidae*

Kjo familje përbëhet nga 2 gjini dhe 4 lloje: *Morone* me 4 lloje në Amerikën e Veriut dhe *Dicentrarchus* me dy lloje në Atlantikun Lindor dhe në detin Mesdhe. Ato dallohen për shkak të një çifti pendësh dorsale të ngushta dhe një vije mjaft të zgjeruar që arrin deri në pjesën e pasme të pendës kaudale. Në Evropë, llojet e kësaj familje gjenden kryesisht në ujëra të njelmëta, ndërsa vetëm levreku gjendet në habitate me ujëra të embla.

Levreku

(*Dicentrarchus labrax*)

Levreku është lloj vendas në lumin e Bunës. Ai është një lloj detar, por që preferon grykëderdhjen e lumit për të jetuar dhe gjatë verës depërton dhe hyn në rrjedhat e lumit. Ngjyrat e tij janë të variueshme, duke filluar nga gri e errët në blu apo jeshile.



Sezoni i peshkimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 1 m

P: 5 kg.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Mbipeshkimi, pasi është një lloj që rritet ngadalë.

Familja *Mugilidae*

Llojet e kësaj familje janë kryesisht detare, por disa hyjnë në laguna apo lumenj, ndërsa disa lloje banojnë në mjedise me ujëra të embla.

Ata dallohen nga koka e sheshtë dhe jetojnë në thellësi më të vogla se 200 m, mbi fundet me baltë. Vezët i lëshojnë në det. Të gjithë llojet janë të ngjashëm me njëri-tjetrin në formë dhe kanë ngjyrë të argjendtë, duke i bërë të vështirë për t'u identifikuar.

Në lumin e Bunës, gjenden dy lloje nga kjo familje: *Liza ramada* dhe *Mugil cephalus*.



Qefulli i vjeshtës (*Liza ramada*)

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 10-20 cm

P: 2.9 g.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Shkatërrimi i habitateve.

Qefulli i vjeshtës është një lloj vendas që gjendet në Lumin e Bunës.

Edhe pse një lloj detar, hyn në mjedise ujore të njelmëta në grykëderdhjen e Bunës.

I pëlqen uji i embël dhe ngjitet deri në rrjedhën e sipërme të lumenjve.

Ngjyrat e trupit janë grija dhe e bardha.



Qefulli i verës (*Mugil cephalus*)

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 1.2 cm

P: 8 kg.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Shkatërrimi i habitateve.

Lloji vendas që gjendet në lumin e Bunës, qefulli i verës, paraqitet me një gamë ngjyrash që shtrihen nga gri në të kaltër, kafë të gjelbër dhe ngjyrë të bardhë argjendi. Atë e gjejmë në ujëra shumë të kripura dhe në ato të embla. Preferon gjithashtu grykëderdhjet e lumenjve dhe të përrenjve, si dhe hyn në ligatina me rërë apo funde me baltë.

Familja *Percidae*

Kjo është një familje që dominohet kryesisht nga peshq të ujërave të ëmbla.

Në këtë familje gjenden rreth 180 lloje dhe 10 gjini, që janë vendase në Evropë, Azinë Qendrore dhe Amerikën e Veriut. Ata dallohen nga familje të tjera për shkak të një vije të vetme laterale të vazhduar, pjesës anteriore më të lartë se pjesa posteriore, dhe 1-2 shylla anale.

Kjo familje, e cila përbëhet nga lloje vendase, endemike dhe të indoktuara, banojnë kryesisht ujra të ëmbla. Në lumin e Bunës, llojet nuk janë vendase, por të indoktuara.

Sharroku (*Perca fluviatilis*)

Sharroku është lloj i induktuar në lumin e Bunës.

Preferon të jetojë në lumenj me rrjedhje të qetë, në liqene të thella apo pellgje, por shmang ujërat e ftohta dhe me rrjedhje të shpejtë. Karakterizohet nga një ngjyrë e gjelbër në kafë dhe i pajisur me 5-8 vija me ngjyrë të zezë.



Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gjmax: 51 cm **P:** 4. 75 kg.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Humbja e habitateve dhe llojet invazive.

Familja *Poeciliidae*

Është një familje e madhe që përfshin peshq me trup të vogël, të cilët banojnë në ujëra të embla dhe të njelmëta, nga Amerika e Veriut dhe Jugut deri në Afrikë.

Meshkujt e kësaj familje kanë pendën anale të modifikuar në një organ të përmbysur (gonopodium), përmes të cilit kalon sperma në trupin e femrës.

Një numër i konsiderueshëm i llojeve të kësaj familje janë pjesë e tregtisë së peshqve të akuariumit, dhe disa janë gjetur edhe në ujrat evropiane.

Peshku mushkonjë (*Gambusia holbroki*)



Ky është lloj invaziv i induktuar në lumin e Bunës.

Preferon kryesisht mjedise me ujë të ngrohtë, me rrjedhje të qetë dhe të ngadaltë. Atë e gjejmë në thellësi më pak se 10 cm.

Paraqitet me ngjyrë jeshile të errët, kafe dhe blu të errët, duke pasur gjithashtu ngjyrë argjendi.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 4 cm

P: 1.9 g.

SB: Rrezik i ulët (LC)

Kërcënimet: Ndotja dhe shkatërrimi i habitateve.


Familja *Salmonidae*

Janë peshq me trup të mesëm dhe të mëdhenj që banojnë pothuajse në të gjitha habitatet me ujë të pastër, të ftohtë dhe të mirëoksigjenuara.

Salmonët janë lloje vendase në hemisferën veriore, por ato janë induktuar në mënyrë të gjerë për akuakulturë në ujërat e ftohta në të gjithë botën. Gjithashtu është një nga grupet e peshqve më të ndikuar nga impakti njerëzor.

Ruajta e tyre vështirësohet për shkak të përdorimit si stok të llojeve apo popullatave të salmoneve aliene, të përdorur për qëllime ekonomike. Paraqesin forma dhe përmasa të larmishme, që shkakton dhe vështirësi në identifikimin e tyre.

Trofta e Drinit (*Salmo farioides*)



Trofta e Drinit është lloj vendas që gjendet në lumin e Bunës dhe është endemik i detit të Adriatikut.

Preferon mjediset me ujë të pastër dhe me rrjedhje të shpejtë dhe shërben si një tregues biologjik i cilësisë së ujit. Karakterizohet nga një ngjyrë e argjendtë dhe me njolla të zeza në pjesën kurrizore.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gj: 3-4 cm

P: 400 gr.

SB: Jo i kërcënuar

Kërcënimet: Ndotja, mbishfrytëzimi.

Trofta e ylbhtë (*Oncorhynchus mykiss*)



Trofta e ylbhtë është lloj i induktuar në lumin e Bunës, i cili paraqitet me ngjyrë të argjendtë në pjesën e poshtme dhe me një shirit me ngjyrë të kuqe në pjesën e sipërme.

Atë e gjejmë në mjedise me ujëra të kripura, të njelmëta dhe të embla. Preferojnë mjedise me ujëra të ftohta, por përshtaten edhe në mjedise ujore me temperatura të ngrohta.

Sezoni i shumimit:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Gjmax: 1.2

Pmax: 24 kg.

SB: Ky lloj nuk është i rrezikuar.

Autoritetet përgjegjëse dhe kontakte:

Institucioni	Përgjegjësia	Kontakt - Albania
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Politika, Legjislacion	https://turizmi.gov.al/kontakto/
Inspektoriati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit (IKMT)	Inspektim, Investigim, Zbatim ligji	Nr. +355697028105
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM)	Inspektim, Investigim, Zbatim të ligjit në rrejetin e Zonave të Mbrojtura	Nr. +355 69 364 7063 Email: Info@akzm.gov.al
Policia e Shtetit	Hetim penal	Nr. 129. Email: policiaeshtetit@asp.gov.al
Organizata e Menaxhim Peshkimit (OMP)	Menaxhim, rregullim dhe monitorim të aktivitetit të peshkimit dhe stokut të peshkut	Nr. 022 620 046 / +355 67 691 8777. E-mail: ariancinari@gmail.com
Policia Kufitare Shkoder	Patrullim për peshkim të paligjshëm	Nr. +355 69 411 0262. E-mail: sallaoperativeshkoder@ASP.gov.al
Policia Bashkiake	Hetim administrativ	Nr. +355 22400150. Email: mjedisi@bashkiashkoder.gov.al
PPNEA - Birdlife Albania	Monitorim, ndërgjegjësim dhe studim mbi gjëndjen e mjedisit	Nr. 04 562 8954 Email: contact@ppnea.org

Literatura:

- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (<https://akzm.gov.al/>)
- Dhora, Dh. (2017): Karakteristikat e Kompleksit Hidrologjik të lumenjve Drini dhe Buna, si dhe liqeneve të Shkodrës, Ohrit, Prespës së Madhe dhe të Vogël. Fiorentia, Shkodër.
- IUCN (2024): The IUCN Red List of Threatened Specie, Versioni 2024-2. (www.iucnredlist.org).
- Jörg, F. & Maurice, K. (2007): Handbook of European freshwater fishes. Cornol, CH: Publications Kottelat, Switzerland. ISBN: 978-2-8399-0298-4.
- Froese, R & Pauly, P. (2024): FishBase. Word Wide Web electronic publication. (Ed) (www.fishbase.org), (10/2024).
- Jörg, F. & Maurice, K. (2007): Handbook of European freshwater fishes. Cornol, CH: Publications Kottelat, Switzerland. ISBN: 978-2-8399-0298-4.

Lista e llojeve:

Shqip	Latinisht	Nr. faqes
Amuri i bardhë	<i>Ctenopharyngodon idella</i>	34
Aterina symadhe	<i>Atherina boyeri</i>	19
Ballëgjeri i bardhë	<i>Hypophthalmichthys nobilis</i>	34
Ballëgjeri larosh	<i>Hypophthalmichthys molitrix</i>	36
Barkëgjera e Ohrit	<i>Alburnoides ohridanus</i>	28
Blenidi i ujërave të embla	<i>Salariopsis fluviatilis</i>	21
Blini	<i>Acipenser sturio</i>	17
Blini i bardhë	<i>Acipenser naccari</i>	17
Burdullaku i Shkodrës	<i>Pomatoschistus montenegrensis</i>	41
Gjuca e Shkodrës	<i>Alburnus scoranza</i>	28
Grunci i karsteve	<i>Phoxinus phoxinus</i>	29
Gurnecka e Ohrit	<i>Cobitis ohridana</i>	25
Gurnecka e Zetës	<i>Barbatula zetensis</i>	20
Gurnecka me gjëmbe e Ballkanit	<i>Sabanejewia balcanica</i>	25
Idhtaku	<i>Rhodeus amarus</i>	34
Karasi i artë	<i>Carassius auratus</i>	31
Karasi Prusian	<i>Carassius gibelo</i>	30
Krapi	<i>Cyprinus carpio</i>	30
Krapi i zi	<i>Mylopharyngodon piceus</i>	37
Kubla liqenore	<i>Alosa fallax</i>	29
	<i>Lampetra soljani</i>	22
Levreku	<i>Dicentrarchus labrax</i>	43
Lina	<i>Tinca tinca</i>	38
Lloska e Shkodrës	<i>Scardinius knezevici</i>	37
Mlyshi i Drinit	<i>Squalius platyceps</i>	32

Ngjala	<i>Anguilla anguilla</i>	18
Njëmustakori i Shkodrës	<i>Gobio skaderensis</i>	41
Njila e Ohrit	<i>Chondrostoma ohridanus</i>	31
Notaku	<i>Pseudorasbora parva</i>	34
Paroshja	<i>Citharus linguatula</i>	26
Pëllëmbëza	<i>Megalobrama terminalis</i>	36
Peshku farëkungull	<i>Lepomis gibbosus</i>	23
Peshku kokëviç kafe	<i>Ameiurus nebulosus</i>	42
Peshku mushkonjë	<i>Gambusia holbroki</i>	46
Qefulli i verës	<i>Mugil cephalus</i>	45
Qefulli i vjeshtës	<i>Liza ramada</i>	45
Sharroku	<i>Perca fluviatilis</i>	46
Skorti i bardhë	<i>Rutilus albus</i>	32
Skorti i Prespës, Pllotica	<i>Rutilus prespensis</i>	33
Skorti i zi, Skorti i Ballkanit	<i>Pachichilon pictum</i>	33
Skorti me vizë	<i>Telestes montenigrinus</i>	38
Trigjilpërëza	<i>Gasterosteus acuelatus</i>	39
Trofta e Drinit	<i>Salmo farioides</i>	48
Trofta e ylbhtë	<i>Oncorhynchus mykiss</i>	48

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Peshqit e lumit Buna dhe deltës së saj / përgat. Redon Hasanllari, Xhemal Xherri ; red.: Lorena Pyze Xhafaj, Tea Gjonaj . - Tiranë : M&B, 2025.
54 f. : me il. ; 14.5x21 cm.

ISBN 9789928820761

I.Hasanllari, Redon II.Xherri, Xhemal
1.Lumenj 2.Peshq 3.Lumi i Bunës

597.2/.5(496.5:282)

Rreth Projektit

“Vendosja e themeleve për një të ardhme të qëndrueshme për Peizazhin e Mbrojtur Lumi Buna - Velipojë në Shqipëri dhe Deltën e Bojanës në Mal të Zi”, është një projekt i mbështetur nga Fondi i Partneritetit të Ekosistemit Kritik - CEPF (grante të vogla) dhe është i fokusuar në lumin ndërkuftar Buna dhe deltën e saj, me synimin kryesor rritjen e njohurive për llojet e ujërave të embla që jetojnë në këtë ekosistem, nëpërmjet studimeve inovative si analiza e ADN-së. Gjithashtu, në bazë të të dhënave të mbledhura u zbatuan veprime ruajtjeje, si dhe u zhvilluan disa takime me aktorë të rëndësishëm me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe ruajtjen e këtyre ekosistemeve të vlefshme.

Organizata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) është organizata e parë mjedisore e themeluar në Shqipëri në vitin 1991 dhe aktualisht përfaqëson organizatën më të madhe në vend dhe një ndër institucionet më të specializuara në fushën e studimit, ruajtjes së biodiversitetit dhe mjedisit natyror.

PPNEA ka për qëllim ruajtjen e llojeve dhe zonave me vlera të larta natyrore në vend, duke ndihmuar në rimëkëmbjen e popullatave të rrezikuara të llojeve të jetës së egër dhe ruajtjen e habitateve të tyre.

PPNEA punon gjithashtu për trajnimin, edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e grupeve të veçanta të interesit dhe publikut të gjerë në fushën e konservimit dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Shqipëri.



Partnerët:



ISBN 978-9928-820-76-1



9 789928 820761 >